

LIGJI Nr. 05/L -081**PËR ENERGJINË****Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR ENERGJINË**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME****Neni 1****Qëllimi**

1. Ky ligj përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme përmes të cilave drejtohen veprimtaritë në sektorin e energjisë në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të furnizimit të sigurt, të qëndrueshëm dhe të cilësisë së lartë me energji, për të krijuar kushte për një treg të hapur funksional, transparent dhe konkurrues, duke promovuar shfrytëzimin më eficient të energjisë, rritjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme dhe bashkëprodhimin, mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet e energjisë dhe veprimet me të cilat krijohen dhe në bazë të të cilave zbatohet politika e energjisë dhe planifikimi i zhvillimit të sektorit të energjisë.

2. Ky ligj është pjesërisht në përputhje me Direktiven 2009/72/EC, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, Rregulloren Nr.714/2009/EC, për kushtet për qasje në rrjetin për shërbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, dhe Direktivën Nr. 2009/28/EC lidhur me promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Neni 2**Fushëveprimi**

1. Fushëveprimi i këtij ligji përfshin përcaktimin e kornizës rregullative për zhvillimin e politikave dhe strategjive, rolin e akterëve në zbatimin e tyre për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe efikas me energji.

2. Ky ligj përfshin energjinë elektrike, energjinë termike, gazin natyror dhe energjinë nga burimet e ripërtërishme dhe përcakton:

2.1. zhvillimin dhe zbatimin e Strategjisë së energjisë (në tekstin e mëtejme: Strategjia), përfshirë parashikimin e bilanceve të energjisë, politikat për eficiencën e energjisë, bashkëprodhimin dhe burimet e ripërtërishme të energjisë;

2.2. rolin e Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria), qeverisjes lokale dhe institucioneve tjera dhe i siguron publikut mundësi për pjesëmarrje të gjerë në zhvillimin e Strategjisë së Energjisë dhe në zbatimin e saj;

2.3. veprimtaritë për rregullimin e sektorit të energjisë që kryhen nga Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejshëm: Rregullatori);

2.4. ngritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë;

2.5. vendosjen e detyrimeve për shërbim publik ndaj ndërmarrjeve të energjisë, kurdo që kjo është e duhur dhe e nevojshme;

2.6. masat që mund të merren në rast të emergjencave energjetike;

2.7. shërbimet universale;

2.8. rregullat për mbrojtjen e konsumatorit;

2.9. nxjerrjen e akteve nënligjore nga Ministria për çështje të specifikuara në këtë ligj.

3. Me qëllim të avancimit të interesit publik përmes nxitjes së investimeve në ndërmarrjet e energjisë, ky ligj i përcakton dhe siguron të drejtat e ndërmarrjeve të energjisë mbi pronën që aktualisht është në shfrytëzim ose posedim të tyre që është e nevojshme për operimin ose mirëmbajtjen e stabilimenteve ekzistuese energjetike si dhe të drejtave pronësore të cilat në të ardhmen mund të nevojiten nga ndërmarrjet e energjisë për ushtrimin e veprimtarive energjetike.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Termat e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Aktivitete të energjisë** - realizim i një apo më shumë veprimtarive të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit apo depozitimit të energjisë;

1.2. **Bashkëprodhim** - proces i prodhimit të njëkohshëm të energjisë elektrike dhe termike nga një burim energjetik gjatë të njëjtit proces teknologjik.

1.3. **Bilanc i Energjisë** - dokument zyrtar në të cilin paraqitet parashikimi i kërkesës totale për energji për periudhën një (1) vjeçare ose dhjetë (10) vjeçare si dhe masat që planifikohen të zbatohen për përmbushjen e kërkesës për energji.

1.4. **Biokarburantet** - karburante të lëngëta apo të gazta, të prodhuara nga biomasa, që përdoren në transport.

1.5. **Burimet e Ripërtërishme të Energjisë** - burime të ripërtërishme jofosile të energjisë siç janë: energjia nga era, energjia diellore, ujërat gjeotermale, energjia e valëve, energjia e ujit, biomasa, gazi i deponive të mbeturinave, gazi nga trajtimi i ujërave të zeza, bogazi si dhe çdo teknologji që prodhon energji elektrike dhe e ka

certifikatën e institucioneve garantuese për këtë teknologji;

1.6. **Energji nga burime të ripërtërishme** – energji nga burime të ripërtërishme jofosile, siç janë energjia nga uji, era, dielli, deti, biomasa, energjia aerotermike, energjia gjeotermike, energjia nga gazrat e deponive, nga gazrat nga stabilimentet e trajtimit të ujërave të zeza dhe nga biogazi;

1.7. **Biomasa** – pjesë të e biodegradueshme të produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga bujqësia (përfshirë substancat bimore dhe shtazore), pylltaria dhe industrinë e ndërlidhura, përfshirë peshkatarinë dhe akuakulturën, si dhe pjesët e biodegradueshme të mbeturinave industriale dhe komunale;

1.8. **Caqet e energjisë së ripërtërishme** – caqe politike të arritjes së një sasive të caktuar të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë brenda afatit të caktuar në këtë ligj;

1.9. **Biolëngjet** – karburante të lëngshme që shfrytëzohen për qëllime energjetike përveç transportit, përfshirë për energji dhe ngrohje dhe ftohje, të prodhuara nga biomasa;

1.10. **Bruto konsumi përfundimtar i energjisë** – sasi e energjisë që i dërgohet sektorëve të industrisë, transportit, amvisërive, shërbimeve përfshirë shërbimet publike, bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë, përfshirë konsumin e energjisë elektrike dhe ngrohjes nga degët përkatëse, me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike dhe ngrohjes duke përfshirë humbjet e energjisë elektrike dhe ngrohjes, në shpërndarje dhe transmetimit;

1.11. **Efiçienca e energjisë** – raport mes performansës, shërbimit, produktit, apo energjisë së fituar dhe energjisë së shpenzuar për këtë qëllim;

1.12. **Energji** - çdo formë e prodhuar e energjisë (energji elektrike, energji termike ose e gazit natyror) me qëllim të furnizimit ose të shitjes;

1.13. **Energji elektrike** - formë e energjisë potenciale të ngarkesave në fushën elektrike, e cila përmes përçuesve metalikë përcillet te konsumatorët;

1.14. **Energji termike** - energji për ngrohjen/ftohjen e hapësirave, ngrohjen e ujit sanitar dhe ujit industrial, që transportohet dhe shpërndahet përmes ujit, avullit, ose gazrave, e përfituar nga stabilimentet e energjisë termike, duke përdorur lëndët djegëse, burimet gjeotermale, energjinë solare, energjinë termike të pashfrytëzuar, me të cilën furnizohen konsumatorët përmes sistemeve qendrore të energjisë termike;

1.15. **Furnizim** - shitje, përfshirë rishitjen e energjisë tek konsumatorët;

1.16. **Furnizues** – ndërmarrje e energjisë që kryen veprimtarinë e furnizimit;

1.17. **Furnizim i mundësisë së fundit** – shërbim i detyrueshëm publik i furnizimit me energji elektrike apo me gaz në kushte të rregulluara për konsumatorin fundor, i cili në kushte të caktuara ka mbetur pa furnizues;

1.18. **Gaz** - gaz natyror dhe të gjitha llojet e tjera të gazrave (gazi i lëngshëm natyror, gazi i lëngshëm i naftës, gazi i lëngshëm i naftës së avulluar, gazi i qytetit, biogazi dhe

gazi nga biomasa), në atë masë që këto gazra munden teknikisht dhe në mënyrë të sigurt të përzihen në rrjedhën e gazit natyror dhe të transportohen nëpërmjet sistemit të gazit;

1.19. **Gazi natyror** - përzierje e komponimeve të hidrokarbureve, në gjendje të gaztë ose në përzierje me naftën e papërpunuar në rezervuarët natyror nëntokësorë. Hidrokarburet parësore, që zakonisht gjenden në përzierje, janë: metani, etani, propani, butani dhe pentani;

1.20. **Interkonektor** - linjë e transmetimit e cila kalon apo përshkon përgjatë një kufiri ndërmjet Palëve Kontraktuese dhe që lidh sistemet shtetërore të transmetimit të Palëve Kontraktuese.

1.21. **Kodet** - rregulla që parashikohen për themelimin e dizajnit minimal teknik, kushtet dhe standardet operative, dhe kushtet komerciale për aktivitetet përkatëse në sektorin e energjisë, për të cilat ligji kërkon që t'i dorëzohen për miratim Rregullatorit;

1.22. **Konsumator** - konsumator me shumicë ose konsumatorin fundor të energjisë;

1.23. **Konsumator me shumicë** - person fizik ose juridik që blen dhe shet energji, brenda apo jashtë sistemit në të cilin është themeluar, duke përjashtuar shitjen e energjisë konsumatorit fundor;

1.24. **Konsumator fundor** - konsumator që blen energji për përdorim vetanak;

1.25. **Konsumator familjar** - konsumator që blen energji për konsum vetanak për ekonominë e vet familjare, duke mos përfshirë veprimtaritë komerciale apo profesionale;

1.26. **Konsumator në nevojë** - konsumator familjar i energjisë i cili për shkak të statusit të tij social dhe / ose gjendjes shëndetësore, ka të drejtë për t'u furnizuar me energji me kushte të veçanta, të përcaktuara nga Ministria përkatëse për mirëqenie sociale, në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike;

1.27. **Konsumator jofamiljar** - person fizik ose juridik që blenë energji që nuk e shfrytëzon për nevoja të tij shtëpiake ku përfshihen prodhuesit dhe blerësit me shumicë;

1.28. Lidhje në rrjet/sistem - lidhje fizike e stabilimenteve të një ndërmarrjeje të energjisë me rrjetin e transmetimit/transportit ose të shpërndarjes/sistemit, sipas kushteve të përcaktuara;

1.29. **Licenca** - dokument i lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji, që i mundëson bartësit të licencës të ushtrorë aktivitete në sektorin e energjisë për të cilat nevojitet licenca në përputhje me dispozitat e ligjeve që kanë të bëjnë me sektorin e energjisë;

1.30. **Metodologjia tarifore** - rregulla, metoda dhe parime që përcaktohen nga Rregullatori për t'u zbatuar në vendosjen e tarifave të rregulluara;

1.31. **Ministria** - Ministri përgjegjëse për sektorin e energjisë.

1.32. **Ndërmarrje e energjisë** – person fizik apo juridik përgjithësisht i organizuar si shoqëri aksionare që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit,

transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të organizuar të energjisë dhe është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike ose të mirëmbajtjes që ndërlidhen me veprimtaritë e cekura, por nuk përfshinë konsumatorin fundor;

1.33. **Obligimi i shërbimit publik** - detyrim i vendosur për një ndërmarrje të energjisë që mund të ndërlidhet me sigurinë e furnizimit, rregullsinë, cilësinë, çmimin e furnizimit, efikasitetin e energjisë, energjinë nga burimet e ripërtërishme si dhe mbrojtjen e mjedisit, që nuk është diskriminues dhe nuk shtrembëron konkurrencën përtej masës që është e domosdoshme për të arritur ofrimin e shërbimit publik në fjalë;

1.34. **Shërbim publik** – shërbim që është në dispozicion në çdo kohë për konsumatorët fundorë dhe për ndërmarrjet e energjisë, me çmim të rregulluar dhe/ose me kushtet e qasjes dhe përdorimit të shërbimeve të energjisë, të cilat duhet të jenë në dispozicion, adekuate dhe të qëndrueshme, duke e marrë parasysh sigurinë, rregullsinë dhe cilësinë e shërbimit, mbrojtjen e mjedisit, efikasitetin e përdorimit të energjisë dhe mbrojtjen e ambientit, e cila kryhet në përputhje me parimet e transparencës dhe të mosdiskriminimit dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve të caktuara me ligj;

1.35. **Shërbim universal** - shërbim i detyrueshëm i furnizimit publik me energji elektrike për t'ua siguruar kategorive të caktuara të konsumatorëve të drejtën të furnizohen me energji elektrike të cilësisë së kërkuar, me tarifa të arsyeshme, lehtë të krahasueshme, transparente, të paanshme dhe jodiskriminuese;

1.36. **Shpërndarje e energjisë** - shpërndarje e energjisë përmes rrjetit/sistemit të shpërndarjes;

1.37. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes** - person fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjatë të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë;

1.38. **Operator i Sistemit të Transmetimit** – person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe sipas nevojës, zhvillimin e rrjetit të transmetimit në një zonë të caktuar dhe kurdo që kjo është e mundur, interkonektorët me sistemet tjera dhe për të garantuar aftësinë afatgjatë të rrjetit për të përmbushur kërkesat për transmetimin e energjisë elektrike;

1.39. **Pajisjet e matjes** – instrumente të regjistruara në regjistrin e pajisjeve matëse të certifikuar në Republikën e Kosovës, që përdoren për matje të energjisë së prodhuar, transmetuar, shpërndarë, furnizuar dhe të konsumuar;

1.40. **Planifikim afatgjatë** - planifikim i nevojave për investime në kapacitetet e gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes në bazë afatgjatë me synim të plotësisë të kërkesave të sistemit për energji dhe sigurimin e furnizimit të konsumatorëve;

1.41. **Prodhim** - proces fizik ose kimik i konvertimit të karburanteve ose të burimeve të ripërtërishme të energjisë në energji elektrike, në ngrohje ose në forma të tjera të energjisë.

1.42. **Prodhues** - person fizik apo juridik që ushtron veprimtarinë e prodhimit të energjisë;

1.43. **Prodhim i gazit** – prodhim, dërgim dhe shitje e gazit, duke mos e përfshirë shfrytëzimin e gazit natyror;

1.44. **Prodhues i energjisë** - ndërmarrje e energjisë që prodhon energji dhe merr pjesë në tregun e energjisë;

1.45. **Spektori i energjisë** - aktivitete të cilat përfshijnë prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, transportin, depozitimin, shitjen, rishitjen, blerjen dhe furnizimin e energjisë;

1.46. **Siguria** - siguri teknike dhe siguri e furnizimit me energji;

1.47. **Siguri e furnizimit** - mundësia e sistemeve të energjisë për t'i furnizuar konsumatorët fundorë me sasi adekuate të energjisë, në mënyrë që t'i përmbushin nevojat e veta;

1.48. **Sistem interkonektiv** – një numër i sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të ndërlidhura mes vete përmes një ose më shumë interkonektorëve;

1.49. **Stabilimente energjetike** - të gjitha instalimet, ndërtesat, objektet, duke përfshirë objektet ndihmëse ose të ndërlidhura, sistemet dhe pajisjet, duke përfshirë shtyllat, shtyllat e tensionit të lartë, linjat e transmetimit ose të shpërndarjes dhe tubacionet, pavarësisht nëse janë mbi ose nën tokë që shfrytëzohen nga një ndërmarrje e energjisë për ushtrimin e aktiviteteve të saj energjetike ose që janë pjesë e një centrali prodhues, sistemit të transmetimit ose sistemit të shpërndarjes ose që janë pjesë e pajisjeve që janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me pajisjet e konsumatorëve, interkonektorët ose linjat direkte ose (vetëm për qëllime të nenit 28 të këtij ligji) në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfrytëzohen nga një ndërmarrje e energjisë për ushtrimin e aktiviteteve të saj minerare në bazë të të drejtave të ndërmarrjes së energjisë sipas licencës ose lejes përkatëse për ushtrimin e këtyre aktiviteteve minerare;

1.50. **Shpërndarja** – transportim i energjisë, përmes sistemeve të shpërndarjes, me qëllim të dërgimit të saj deri tek konsumatori, por duke mos përfshirë furnizimin;

1.51. **Tarifa** - çmim apo një grup çmimesh për energji, për përdorim të sistemeve të energjisë ose për shërbime tjera të ndërlidhura me energjinë;

1.52. **Tokë publike** - tokë që është në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në Republikën e Kosovës;

1.53. **Transfer statistikor** – Marrëveshje të cilën mund ta lidhin palët me qëllim të transferit statistikor të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme;

1.54. **Transmetim** – transportim i energjisë përmes sistemeve të tensionit të lartë dhe sistemeve të ndërlidhura të tensionit të lartë, me qëllim të dërgimit deri te konsumatorët fundorë, apo tek operatorët e sistemit të shpërndarjes, por pa e përfshirë furnizimin;

1.55. **Transit** – transferim i energjisë me origjinë nga një shtet tjetër, i destinuar për një shtet të tretë, nëpër rrjet në territorin e Kosovës, ose transmetimi i energjisë me origjinë nga një shtet tjetër, i destinuar për po atë shtet nëpërmjet rrjetit të Kosovës;

1.56. **Tregtar** - një entitet që blen dhe shet energji, duke e përjashtuar shitjen e energjisë për konsumatorët fundorë;

1.57. **Treg i energjisë** - blerje dhe shitje e energjisë, duke i përjashtuar shitjet për klientët fundorë;

1.58. **Zyra e Rregullatorit për Energji - Rregullatori** – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë;

1.59. **Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ECS)** - institucion që siguron mbështetje administrative për Këshillin Ministror, Grupin e Nivelit të Lartë të Përhershëm, Bordit Rregullator dhe Forumet, në udhëheqjen e procesit të zhvillimit të Komunitetit të Energjisë.

2. Termat tjera të përdorura në këtë ligj, kanë kuptimin e njëjtë si në Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Gazin Natyror dhe Ligjin për Energji Termike.

Neni 4

Obligimi për Shërbim Publik

1. Ndërmarrjet e energjisë që ngarkohen me obligimin për shërbim publik duhet të sigurojnë ofrimin e shërbimit publik në pajtim me kushtet e përcaktuara në licencë.

2. Detyrat dhe obligimet e ndërmarrjeve të energjisë, të ngarkuara me obligime të shërbimit publik, përcaktohen në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 5

Konsumatorët në nevojë

1. Ministria përgjegjëse për çështje sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji, me ministrinë përgjegjëse për financa dhe në konsultim me Rregullatorin, si dhe me aktorët tjerë relevantë, e përgatisin Planin Social të Veprimit për Energji, i cili miratohet nga Qeveria.

2. Plani social i veprimit për energji duhet t'i përmbajë kushtet, kriteret si dhe kategoritë e personave në nevojë, që e gëzojnë të drejtën e përfitimit si konsumatorë në nevojë, në pajtim me Ligjin për energjinë elektrike dhe me Ligjin për gazin natyror.

KAPITULLI II

STRATEGJIA E ENERGIJË, PROGRAMI I ZBATIMIT DHE BILANCET E ENERGIJË

Neni 6

Strategjia e Energjisë

1. Strategjia përcakton politikat e energjisë dhe të planifikimit për zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë.

2. Strategjia identifikon sfidat e rëndësishme me të cilat ballafaqohet sektori i energjisë, orienton

zhvillimin e politikave të përshtatshme për shndërrimin e sektorit të energjisë në një sektor të qëndrueshëm dhe të vetë financueshëm që ofron shërbime cilësore energjetike, ekonomikisht të favorshme për konsumatorët në Kosovë dhe identifikon politikat dhe masat kryesore që duhet të ndërmerren për avancimin e reformave në sektor, për ta mundësuar tërheqjen e investimeve private, mbrojtjen e mjedisit dhe integrimin e sistemit energjetik të Kosovës me ato rajonale dhe evropiane.

3. Strategjia hartohet nga Ministria dhe përfshinë synimet zhvillimore për sektorin e energjisë sipas nevojës. Ministria siguron se përgatitja e Strategjisë do të kryhet në koordinim me zhvillimet tjera relevante politike, si brenda Ministrisë ashtu edhe brenda Qeverisë.

4. Strategjia i dorëzohet Qeverisë nga Ministria për shqyrtim dhe aprovim. Pas aprovimit nga Qeveria, Strategjia i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratim.

5. Ministria, në intervale kohore prej jo më shumë se tre (3) vjet, kryen rishikimin e Strategjisë dhe përgatit Strategjinë për një periudhë të ardhshme dhjetë (10) vjeçare në pajtim me procedurat e përcaktuara sipas dispozitave të këtij neni. Të gjitha modifikimet e propozuara për Strategjinë duhet të parashtrohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

6. Gjatë hartimit të Strategjisë, Ministria konsultohet me Rregullatorin, Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, energjisë termike dhe gazit natyror dhe subjektet tjera të licencuara nga Rregullatori, përfaqësuesit e konsumatorëve si dhe autoritetet tjera publike relevante në Kosovë. Pas përfundimit të Draft Strategjisë, Ministria, duke e siguruar konfidencialitetin e informatave përkatëse, do ta nxjerrë draftin në diskutim publik sipas Rregullorës së Punës së Qeverisë.

7. Strategjia hartohet për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, duke i marrë parasysh rrethanat zhvillimore në Kosovë dhe ka për qëllim:

7.1. të promovojë siguri të furnizimit të energjisë brenda një sektori të sigurt dhe të qëndrueshëm të energjisë, përfshirë promovimin e shumëllojshëm të burimeve të energjisë;

7.2. të sigurojë bilancet adekuate afatgjate ndërmjet furnizimit dhe kërkesës për energji në zhvillimin afatgjatë të sektorit të energjisë, duke marrë parasysh parashikimet e kërkesave për energji si dhe diversifikimin e burimeve të energjisë;

7.3. të shfrytëzojë në mënyrë të arsyeshme burimet vendore të energjisë sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

7.4. të mundësojë vazhdimësi të furnizimit të energjisë, përmes kombinimit të niveleve adekuate të kapaciteteve të prodhimit në dispozicion dhe kapaciteteve të mjaftueshme të transmetimit dhe shpërndarjes në Kosovë si dhe interkoneksionet me sistemet tjera;

7.5. të nxisë fleksibilitet në kontraktimin e energjisë dhe shfrytëzimin e energjisë, përmes largimit të barrierave të cilat parandalojnë përdorimin e kontratave të pandërprera apo të cilat parandalojnë përmbylljen e kontratave të kohëzgjatjeve të ndryshueshme për prodhues dhe konsumator;

7.6. të sigurojë shfrytëzimin optimal të energjisë nga burimet e ripërtërishme në pajtim me caqet e parashtruara sa i përket energjisë nga burimet e ripërtërishme;

7.7. të përmirësojë eficientësinë e energjisë dhe të nxisë masa të ruajtjes së energjisë, në konsistencë me caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme;

7.8. të inkurajojë miratimin e teknologjive të menaxhimit të kërkesës në kohë reale, siç janë sistemet e avancuara të matjes;

7.9. të mbrojë interesat e konsumatorëve të energjisë, veçanërisht të konsumatorëve të cenueshëm;

7.10. të sigurojë disponueshmërinë e shërbimit universal dhe mundësinë e zgjidhjes së furnizuesit të energjisë për konsumatorët fundor në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike;

7.11. të sigurojë mjedis të qëndrueshëm gjatë kryerjes së veprimtarive energjetike;

7.12. të promovojë investime në sektorin e energjisë në funksion të përdorimit të teknologjisë së pastër për shfrytëzim të linjitit, në funksion të mbrojtjes së mjedisit;

7.13. të promovojë konkurrencën në sektorin e energjisë bazuar në parimet konkurruese e jodiskriminimit dhe transparencës, përfshirë zhvillimin e tregjeve aktive të shitjes me shumicë të energjisë brenda Kosovës;

7.14. të mundësojë një nivel të duhur të bashkëpunimit me shtetet fqinje, për lidhjen e sistemit të energjisë së Kosovës ose pjesëve të tij, me sistemin e energjisë të Evropës ose me sistemet e vendeve të tjera, dhe për integrimin e tregjeve rajonale të energjisë, duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet e lidhjeve të tilla.

8. Ministria, sipas nevojës, përgatit dokumente që përmbajnë qëndrime dhe udhëzime mbi të gjitha çështjet që janë në pajtim me rolin e Ministrisë në përkufizimin e politikave të energjisë.

9. Të gjitha dokumentet dhe udhëzimet që përgatiten nga Ministria do t'i nënshtrohen kërkesave të njëjta për konsultime publike dhe miratohen nga Ministria.

Neni 7

Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë

1. Bazuar në Strategji, Ministria përgatit dhe Qeveria miraton Programin për Zbatimin e Strategjisë për periudhën tre (3) vjeçare. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e Programit të Strategjisë.

2. Programi për Zbatimin e Strategjisë përcakton masat, programet dhe aktivitetet që duhen zbatuar, përfshirë parashikimin e shpenzimeve dhe burimet e pritura të financimit, afatet kohore për zbatim, subjektet përgjegjëse për zbatimin e të gjitha aktivitetëve dhe aranzhimet monitoruese dhe raportuese mbi progresin.

3. Programi për Zbatimin e Strategjisë, përcakton bashkëpunimin e nevojshëm me organet dhe institucionet e qeverive lokale në lëmin e planifikimit të sektorit të energjisë, si dhe bashkëpunimin e nevojshëm me ndërmarrjet e energjisë dhe organizatat ndërkombëtare.

4. Për zbatimin e detyrave që kanë të bëjnë me Strategjinë, Qeveria miraton akt nënligjorë për themelimin, financimin dhe operimin e zyrave komunale të energjisë, për të adresuar çështjet e zbatimit dhe monitorimit në nivel lokal.

5. Ministritë dhe institucionet tjera të Qeverisë, përfshirë organet e qeverive lokale, këshillojnë dhe ndihmojnë Ministrinë në zbatimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë, në pajtim me detyrat dhe autorizimet e tyre.

6. Ndërmarrjet e energjisë dhe personat tjerë janë të obliguar t'i përmbahen politikave dhe obligimeve që rrjedhin nga Strategjia dhe Programi i Zbatimit të Strategjisë, deri në masën e përcaktuar në Programin e Zbatimit të Strategjisë. Në rastet kur pajtueshmëria me këto politika apo obligime rezulton me kosto shtesë që mbulohen nga ndërmarrjet e energjisë, Ministria, në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit siguron që:

6.1. këto shpenzime të jenë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese; dhe që

6.2. ndërmarrjet e energjisë të jenë në gjendje t'i mbulojnë këto shpenzime të arsyeshme, përmes mjeteve tjera dhe detyrimeve tek konsumatorët.

7. Ministria paraqet raportin vjetor para Qeverisë, mbi progresin në realizimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë. Të gjitha raportet përfshijnë hollësi mbi përparimin përkatës në zbatimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë, në periudhën e mbuluar nga raporti, dhe do t'i paraqesin zhvillimet që priten në periudhën e mbetur të Programit.

Neni 8

Bilanci i Energjisë

1. Parashikimi i kërkesave për energji elektrike, gaz natyror dhe energji termike, mënyra dhe masat e plotësimit të saj përcaktohen në Bilancin Vjetor të Energjisë dhe në Bilancin Afatgjatë të Energjisë që miratohen dhe publikohen nga Rregullatori.

2. Metodologjia, rregullat dhe procedurat e përgatitjes dhe miratimit të Bilancit Vjetor dhe Bilancit Afatgjatë të Energjisë përcaktohen me rregullore të veçantë që hartohet dhe miratohet nga Rregullatori.

3. Në rregulloren e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni rregullohen çështjet lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e operatorëve në përgatitjen e bilanceve të energjisë elektrike, gazit natyror dhe energjisë termike, detyrimet e palëve të përfshira për furnizimin me të dhëna për operatorët përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të bilanceve, përmbajtjen e të dhënave, afatet kohore të dorëzimit të të dhënave dhe procedurat e dorëzimit dhe miratimit.

4. Bilancet afatgjata dhe vjetore të energjisë elektrike zhvillohen nga operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe, pas marrjes së mendimit nga Ministria, dërgohen për miratim të Rregullatorit.

5. Bilancet afatgjata dhe vjetore të gazit natyror zhvillohen nga operatori i sistemit të transmetimit të gazit natyror dhe pas marrjes së mendimit nga Ministria, dërgohen për miratim të Rregullatorit.

6. Bilancet afatgjata dhe vjetore të energjisë termike përgatiten prej operatorëve të sistemeve të shpërndarjes së energjisë termike dhe, pas marrjes së mendimit nga Ministria, dërgohen për miratim të Rregullatorit.

7. Ministria duhet të jep mendimin e saj në lidhje me përputhjen e dokumenteve të bilanceve me dokumentet e strategjive të energjisë dhe programeve të zbatimit të tyre në një afat njëzetë (20) ditë nga dita e pranimit të tyre nga operatorët.

8. Rregullatori, pas miratimit të bilanceve veç e veç, i publikon ato në një dokument unik më së voni deri më pesëmbëdhjetë (15) dhjetor të vitit aktual që i paraprinë periudhës vijuese.

9. Bilanci afatgjatë i energjisë miratohet për një periudhë dhjetë (10) vjeçare. Azhurnimet e bilancit afatgjatë të energjisë miratohen çdo dy (2) vjet.

10. Komponentët e detyrueshëm të bilanceve afatgjata të cekura në paragrafët 4, 5 dhe 6 të këtij neni janë:

10.1. parashikimi i kërkesave;

10.2. parashikimi i furnizimit për mbulimin e kërkesave;

10.3. mënyra për përmbushjen e kërkesave;

10.4. një listë të niveleve të nevojshme të deponimit dhe kapacitetit rezervë të nevojshëm për sigurimin e shkallës së planifikuar të qëndrueshmërisë (stabilitetit) të furnizimit.

11. Bilanci vjetor i energjisë do të miratohet jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) dhjetor të vitit aktual, për vitin e ardhshëm.

12. Komponentet e detyrueshme të bilanceve vjetore të energjisë janë:

12.1. parashikimi i kërkesës për çdo muaj të vitit vijues;

12.2. parashikimi i furnizimit për plotësimin e kërkesës;

12.3. parashikimi i konsumit të lëndëve të para të energjisë, nivelet e rezervave dhe kapacitetet rezervë;

12.4. niveli vjetor i kapacitetit rezervë (kufiri i rezervës) i centraleve të energjisë dhe pajisjeve;

12.5. nivelet e duhura të rezervave operative çdo vit dhe kriteret lidhur me efikasitetin e energjisë për çdo vit.

13. Bilanci vjetor i energjisë, për vitin paraprak, përgatitet, miratohet dhe publikohet nga Agjencia përgjegjëse për statistika zyrtare.

Neni 9

Roli i qeverisjes lokale

1. Organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore të planifikojnë nevojat dhe mënyrën e furnizimit me energji dhe ato dokumente t'i harmonizojnë me Strategjinë dhe

Programin për Zbatimin e Strategjisë, si dhe bilanceve të energjisë.

2. Përveç atyre që percakton paragrafi 1 i këtij neni, organet e qeverisjes lokale duhet të bashkëpunojnë edhe me Ministrinë, Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes në lidhje me të drejtën për qasje në tokë ku duhet të vendosen pajisjet dhe stabilimentet energjetike.

Neni 10

Planet Zhvillimore të Operatorëve të Sistemeve

1. Çdo vit, Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Termike dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror i dorëzojnë Zyrës së Rregullatorit për Energji Planin dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit në bazë të kërkesës dhe furnizimit aktual dhe të parashikuar pas konsultimit më të gjithë akterët relevant. Plani i zhvillimit të rrjetit përmban masa efikase në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit.

2. Plani dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit në veçanti:

2.1. i njofton pjesëmarrësit kryesor të tregut për infrastrukturën që nevojitet të ndërtohet apo të përmirësohet gjatë dhjetë (10) vjetëve të ardhshme;

2.2. përmban të gjitha investimet që janë në zhvillim dhe identifikon investimet e reja që do të ekzekutohen gjatë tre (3) vjetëve të ardhshme; dhe

2.3. ofron një kornizë kohore për të gjitha projektet e investimeve sipas paragrafit 2.2. të këtij neni.

3. Gjatë përgatitjes të planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit, Operatori i Sistemit të Transmetimit bënë supozime të arsyeshme për zhvillimin e gjenerimit, furnizimit, konsumit dhe shkëmbimeve me vendet tjera, duke i marrë parasysh planet e investimit për rrjetet rajonale në kuadër të Komunitetit të Energjisë.

4. Rregullatori konsultohet me të gjithë përdoruesit aktual dhe potencial të sistemit lidhur me planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit në mënyrë të hapur dhe transparente. Personat apo ndërmarrjet që pretendojnë se janë përdorues potencial të sistemit mund të kërkohen që t'i arsyetojnë ato pretendime. Rregullatori publikon rezultatet e procesit të konsultimit, e në veçanti nevojat e mundshme për investime.

5. Rregullatori shikon nëse plani dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit i mbulon të gjitha nevojat për investime të identifikuar gjatë procesit të konsultimeve dhe nëse ai është në pajtim me planin jodetyrues dhjetë (10) vjeçar të Komunitetit të Energjisë për zhvillimin e rrjetit. Plani dhjetë (10) vjeçar jodetyrues për zhvillimin e rrjetit në kuadër të Komunitetit të Energjisë, përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së gjenerimit, për çdo dy (2) vjetë. Nëse ka ndonjë dyshim përkitazi me konsistencën me planin e mbarë komunitetit për zhvillimin e rrjetit, Rregullatori konsultohet me Autoritetin Rregullativ në kuadër të Komunitetit të Energjisë. Rregullatori mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit që ta ndryshojë dhe plotësoj planin e vet dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit. Në këtë proces nuk përfshihet plani dhjetë (10) vjeçar i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë termike.

6. Rregullatori e monitoron dhe vlerëson zbatimin e planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit.

7. Në rastet kur Operatori i Sistemit të Transmetimit, për arsye tjera nga ato që janë jashtë kontrollit të saj, nuk e ekzekuton një investim, i cili, sipas planit dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit është dashur të ekzekutohet në tre (3) vjetët e ardhshme, Rregullatori obligohet të merr së paku një nga masat në vijim për të siguruar që investimi në fjalë është bërë nëse ai investim është ende relevant në bazë të planit të mëvonshëm dhjetë (10) vjeçar për zhvillimin e rrjetit:

7.1. të kërkojë që Operatori i Sistemit të Transmetimit të ekzekutojë investimet në fjalë;

7.2. të organizojë një procedurë të tenderimit të hapur për çdo investitor për investimet në fjalë; apo

7.3. të obligojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit që ta pranojë një rritje të kapitalit për ta financuar investimin e nevojshëm dhe për t'i lejuar investitorët e pavarur që të marrin pjesë në kapital.

8. Në rastet kur Rregullatori i ka përdorur kompetencat e tij sipas paragrafit 2.2 të këtij neni, mund ta obligojë operatorin e sistemit të transmetimit që të pajtohet për njërën apo më shumë nga këto investime si në vijim:

8.1. financimin nga pala e tretë;

8.2. ndërtimin nga pala e tretë;

8.3. vetëndërtimin e aseteve të reja në fjalë;

8.4. vetëoperimin e aseteve të reja në fjalë.

9. Operatori i Sistemit të Transmetimit iu siguron investitorëve të gjitha informatat e nevojshme për realizimin e investimit, i lidh asetet e reja me rrjetin e transmetimit për ta lehtësuar zbatimin e projektit të investimit. Aranzhimet relevante financiare i nënshtrohen për miratim Rregullatorit.

10. Në rastet kur Rregullatori i ka përdorur kompetencat e veta sipas nënparagrafit 7.1 të këtij neni, rregullimet relevante të tarifave e mbulojnë koston e investimeve në fjalë.

11. Planet zhvillimore të përgatitura nga operatorët e energjisë duhet të jenë në pajtim me Strategjinë dhe me programin e zbatimit të Strategjisë dhe duhet të publikohen në ueb-faqen e Rregullatorit.

KAPITULLI III

EFIÇIENCA E ENERGJISË, BASHKËPRODHIMI DHE BURIMET E RIPËRTËRISHME

Neni 11

Politika e efikasitetit të energjisë dhe bashkëprodhimit

1. Qëllimi i politikave të efikasitetit të energjisë dhe bashkëprodhimit është përmirësimi i efikasitetit të energjisë duke shfrytëzuar potencialet e kursimit të energjisë, përmes zbatimit të masave të efikasitetit të energjisë, si dhe nxitja e zbatimit të bashkëprodhimit përmes

teknologjisë me efikasitet të lartë.

2. Efienca e energjisë dhe bashkëprodhimi rregullohen me akte të veçanta ligjore.

Neni 12

Politikat për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë

1. Qëllimi i politikave të burimeve të ripërtërishme të energjisë është promovimi i shfrytëzimit ekonomik e të qëndrueshëm të potencialeve vendore të burimeve të ripërtërishme të energjisë, në funksion të plotësimit të nevojave për energji, rritjes së sigurisë së furnizimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

2. Politikat e burimeve të ripërtërishme të energjisë janë pjesë përbërëse e Strategjisë.

Neni 13

Zbatimi i politikave për burimet e ripërtërishme të energjisë

1. Për zbatimin e politikave të burimeve të ripërtërishme të energjisë, Ministria:

1.1. harton planin dhjetë (10) vjeçar të veprimit për burimet e ripërtërishme të energjisë në përputhje me kërkesat e direktivës përkatëse për burime të ripërtërishme dhe miratohet nga Qeveria;

1.2. përcakton me akt të veçantë nënligjor caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme, në harmoni me kërkesat e direktivës përkatëse të Bashkimit Evropian për burime të ripërtërishme;

1.3. raporton lidhur me zbatimin e planit të veprimit dhe plotësimin e caqeve të energjisë nga burimet e ripërtërishme, në harmoni me kërkesat e direktivës përkatëse të Bashkimit Evropian për burime të ripërtërishme;

1.4. harton akte nënligjore për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme;

1.5. identifikon masat për plotësimin e caqeve të energjisë nga burimet e ripërtërishme;

1.6. lidh marrëveshje për bashkëpunimin ndërkombëtar në zhvillimin e projekteve, apo të skemave mbështetëse të përbashkëta për burime të ripërtërishme, ku përfshihen edhe çështjet që lidhen për transferin statistikor të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

2. Ministria përgjegjëse për sektorin e ndërtimit harton akt nënligjor për përdorimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme në ndërtesa.

3. Ministria përgjegjëse për sektorin e naftës harton akt nënligjor për përdorimin e biokarburanteve në transport.

Neni 14

Qasja e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme dhe bashkëprodhimi në rrjet dhe operimi i rrjetit

1. Gjatë dispeçimit të energjisë së prodhuar, operatori i sistemit të transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes duhet t'i japin përparësi energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe nga bashkëprodhimi, sipas kufizimeve të specifikuara për qëllime të sigurimit të sistemit në Kodin e Rrjetit dhe në rregullat e kodet e tjera.
2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde mbi bartësin e shpenzimeve të përcaktimeve teknike, siç janë lidhjet në rrjet dhe përforcimet e rrjeteve të tyre, të domosdoshme për integrimin e prodhuesve të rinj të energjisë elektrike që furnizojnë me energji elektrike të prodhuar nga burime të ripërtërishme të energjisë në sistemin e ndërlidhur. Këto rregulla dorëzohen për miratim te Rregullatori dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë, sipas kritereve objektive, transparente e jodiskriminuese, veçanërisht duke i marrë parasysh të gjitha shpenzimet dhe përfitimet që dalin nga lidhja e këtyre prodhuesve në sistem.
3. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'i sigurojnë çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike që përdor burime të ripërtërishme të energjisë apo bashkëprodhim, e që dëshiron të lidhet në sistem, vlerësimin e plotë e të hollësishëm lidhur me shpenzimet që krijohen nga lidhja, për të cilin vlerësim operatori i sistemit mund ta ngarkojë një pagesë e cila i pasqyron kostot e arsyeshme të tij.
4. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe operatori i sistemit të shpërndarjes përcaktojnë dhe publikojnë rregullat standarde lidhur me ndarjen e shpenzimeve për instalimin e sistemeve, siç janë lidhja në rrjet dhe përforcimet, ndërmjet të gjithë prodhuesve të energjisë elektrike që përfitojnë prej tyre. Këto rregulla parashtrihen për miratim te Rregullatori dhe ato duhet të jenë në përputhje me Strategjinë, si dhe me aktet e tjera nënligjore.
5. Rregullatori siguron që tarifat e transmetimit dhe të shpërndarjes për lidhje dhe shfrytëzim të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të mos e diskriminojnë operatorin e energjisë elektrike me prejardhje nga burime të ripërtërishme të energjisë, e posaçërisht operatorin me energjinë elektrike të prodhuar nga burime të ripërtërishme të energjisë në rajonet periferike dhe me dendësi të vogël të popullatës.

Neni 15

Caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme

1. Qeveria i cakton caqet vjetore dhe afatgjata të energjisë së ripërtërishme për konsum të energjisë elektrike, të energjisë termike të prodhuar nga burime të ripërtërishme të energjisë dhe nga bashkëprodhimi, si dhe të energjisë nga burime të ripërtërishme që shfrytëzohet në transport. Qeveria do ta miratojë planin shtetëror të veprimit për energji të ripërtërishme për arritjen e caktuar që 25% e konsumit të gjithmbarshëm bruto të energjisë në vitin 2020 të mbulohet nga energjia e ripërtërishme. Plani shtetëror i veprimit për energji të ripërtërishme, pas miratimit do t'i dorëzohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
2. Me arritjen e caktuar të mbulimit të 25% të konsumit të gjithmbarshëm bruto të energjisë në vitin 2020 nga energjia nga burimet e ripërtërishme, Kosova do të mund t'i qaset mekanizmave bashkëpunues me Palët tjera Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë apo me Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian. Korniza e këtij mekanizmi bashkëpunues do të miratohet nga Qeveria me akt të veçantë nënligjor.

3. Caqet afatgjate të energjisë së ripërtërishme hartohen për një periudhë dhjetë (10) vjeçare, në pajtim me metodologjinë e përcaktuar me akte nënligjore, të miratuar nga Ministria.

4. Ministria përgatit dhe nxjerrë akte nënligjore që përfshijnë masat që synojnë përmbushjen e caqeve të energjisë së ripërtërishme dhe propozimet e tilla marrin parasysh si në vijim:

4.1. parimet e tregut konkurrues të energjisë; dhe

4.2. karakteristikat e llojeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë.

5. Ministria harton dhe publikon raportin mbi realizimin e caqeve vjetore afatgjate për burimet e ripërtërishme të energjisë si pjesë e raportit mbi zbatimin e Planit shtetëror të Veprimit për Energji të Ripërtërishme dhe Programit për Strategjinë sipas nenit 7 paragrafi 7 këtij ligji. Raporti duhet të përfshijë një analizë të progresit për realizimin e caqeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë, veçanërisht duke marrë për bazë ndikimin e faktorëve klimatikë. Kjo analizë paraqet shtrirjen e masave për realizimin e caqeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe masat e mundshme përmirësuese për të qenë në rrugë të mirë në arritjen e caqeve të tilla.

6. Rregullatori certifikon prejardhjen e energjisë të prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë sipas kriterëve objektive, transparente dhe jodiskriminuese në përputhje me dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

7. Institucionet e përfshira në promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë do të sigurohen se informatat mbi masat përkrahëse do t'i vëhen në dispozicion të gjithë akterëve relevantë, siç janë: konsumatorët, ndërtimtarët, instaluesit, arkitektët dhe furnizuesit e pajisjeve të ngrohjes, ftohjes dhe energjisë elektrike që shfrytëzojnë energji nga burimet e ripërtërishme.

8. Autoritetet lokale dhe rajonale do të sajojnë programe përkatëse informative, vetëdijësuese, udhëzuese dhe trajnuese, me qëllim të informimit të qytetarëve mbi përfitimet dhe praktikitetet e zhvillimit dhe shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme.

Neni 16

Procedurat administrative, rregulloret dhe kodet për energji të ripërtërishme

1. Qeveria duhet të sigurojë se të gjitha rregullat lidhur me procedurat e autorizimit, certifikimit dhe licencimit do të aplikohen në stabilimente prodhuese dhe infrastrukturën përkatëse të rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes të energjisë elektrike për prodhimin e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes nga burimet e energjisë së ripërtërishme, dhe për të proceduar me transformimin e biomasës në biokarburantë apo produkte tjera, dhe se të njëjtat do të jenë proporcionale dhe obligative.

2. Qeveria do t'i përshkruajë përgjegjësitë e organeve administrative shtetërore, rajonale dhe lokale në lidhje me procedurat e autorizimit, certifikimit dhe licencimit, duke e përfshirë planifikimin hapësinor, për të siguruar bashkërendim dhe përcaktim të qartë të tyre, me orare transparente përkatëse për planifikim dhe ndërtim. Ajo duhet të sigurojë qartësim të procedurave administrative dhe zhvillim ekspeditiv të tyre në nivel përkatës administrativ.

3. Rregullat me të cilat rregullohen autorizimi, certifikimi dhe licencimi janë objektive, transparente dhe proporcionale dhe nuk do të diskriminojnë mes parashtruesve të kërkesave dhe do të marrin parasysh të gjitha veçoritë e teknologjive të ndryshme të energjisë së ripërtërishme.

4. Pagesat administrative të paguara nga konsumatorët, planifikuesit, arkitektët, ndërtuesit dhe instaluesit dhe furnizuesit e pajisjeve dhe sistemeve do të jenë transparente dhe do të ndërlidhen me kostot përkatëse.

5. Procedura më të thjeshta dhe më të pangarkuara të autorizimit, përmes njoftimeve të thjeshta nëse një gjë e tillë lejohet nga korniza rregullative e zbatueshme, do të përcaktohen për projekte më të vogla dhe për pajisje të decentralizuara të prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme, kurdo që një gjë e tillë është e mundshme.

KAPITULLI IV INVESTIMET

Neni 17

Promovimi i investimeve në sektorin e energjisë

1. Ndërtimi i impianteve dhe pajisjeve të reja energjetike, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i tyre duhet të inkurajohet, me kusht që veprimet e tilla të jenë në përputhje me detyrimet e Kosovës ndaj Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë.

2. Inkurajimi i investimeve private në sektorin e energjisë në Kosovë dhe krijimi i një mjedis të favorshëm për investime, duke plotësuar kërkesat për teknologji eficiente dhe mjedisore në përputhje me detyrimet e Komunitetit të Energjisë dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë.

3. Duhet të krijohen skema mbështetëse dhe lehtësira për nxitjen dhe promovimin e prodhimit të energjisë nga burime të ripërtërishme dhe nga bashkëprodhimi, duke i përfshirë pajisjet për ndërtimin e stabilimenteve të reja energjetike.

4. Aty ku planifikohen investime në njësi të reja prodhuese me kapacitet mbi prej (50) megavat (MW) apo më shumë, investitori duhet t'i paraqesë Ministrisë një analizë mbi potencialin e zbatimit të bashkëprodhimit në një investim të tillë në pajtim me kërkesat e Komunitetit të Energjisë.

5. Nëse analiza e parashikuar me paragrafin 4. të këtij neni tregon që bashkëprodhimi mund të zbatohet në investim pa ndikim negativ në profitabilitetin e investimit, Ministria në pajtim me qëllimin e identifikuar në paragrafin 4. të këtij neni për të krijuar një mjedis të favorshëm për investime, mund të kërkojë që bashkëprodhimi të konsiderohet si komponentë e investimit.

6. Me qëllim të lehtësimit të investimeve në sektorin e burimeve të ripërtërishme të energjisë do të themelohet One Stop Shop, me akt të veçantë nënligjor të miratuar nga Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë.

KAPITULLI V RREGULLIMI EKONOMIK I AKTIVITETEVE TË ENERGISË

Neni 18

Rregullimi i aktiviteteve të energjisë

1. Rregullimi ekonomik i aktiviteteve në sektorin e energjisë zbatohet në përputhje me Ligjin për

Rregullatorin e Energjisë, në mënyrë që:

- 1.1. të përkrahë një mjedis të qëndrueshëm për investime në sektorin e energjisë;
 - 1.2. të sigurojë kornizë të duhur për zhvillimin e konkurrencës, dhe evitimin e sjelljes monopolistike, duke përfshirë sigurimin e kushteve transparente dhe jodiskriminuese të gasjes në sistemet e transmetimit dhe të shpërndarjes;
 - 1.3. ta garantojë standardet dhe sigurinë e furnizimit me energji;
 - 1.4. t'i mbrojë interesat e konsumatorëve, duke përfshirë ofrimin e mbrojtjes për konsumatorë në nevojë;
 - 1.5. të përcaktojë një kornizë rregullative transparente dhe jodiskriminuese.
2. Të gjitha veprimtaritë energjetike në sektorin e energjisë ushtrohen në bazë të licencave të lëshuara nga Rregullatori, përveç aktiviteteve për të cilat nuk kërkohet licencë, në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 19

Llojet e aktiviteteve të rregulluara

1. Aktivitetet e energjetisë ushtrohen si aktivitete konkurruese, të bazuara në treg, pa paragjykuar të drejtën e Rregullatorit për të vendosur obligime për shërbim publik, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror.
2. Të gjitha ndërmarrjet e energjisë i shërbejnë interesit të konsumatorëve individualë duke siguruar furnizim të sigurt, efikas dhe të qëndrueshëm me energji elektrike, energji termike apo gaz natyror, duke siguruar shfrytëzim me efikasitet të burimeve të energjisë njëkohësisht duke respektuar mbrojtjen e ambientit, shëndetit, jetës dhe pronës së qytetarëve të Kosovës.
3. Kostot dhe shpenzimet e bëra nga ndërmarrjet e energjisë në lidhje me kryerjen e obligimeve për shërbim publik, pas shqyrtimit me Zyrën e Rregullatorit për Energji për të siguruar arsyeshmërinë e tyre, njihen si tarifa dhe shpenzime të arsyetuara për qëllime të vendosjes së tarifave. Kompensimi për këto kosto nuk duhet të tejkalojë kostot e bëra në ushtrimin e detyrimeve të ofrimit të shërbimeve publike përveç një fitimi të cilin Rregullatori e sheh si të arsyeshëm për këto shërbime.

Neni 20

Kryerja e veprimtarive energjetike

1. Veprimtaritë energjetike të transmetimit, shpërndarjes, organizimit të tregut kryhen si shërbime publike me kushte dhe tarifa të rregulluara.
2. Në pajtim me Ligjin për Energjinë Elektrike, disa kategori të konsumatorëve gëzojnë të drejtën e furnizimit universal dhe përfitojnë nga furnizimi i garantuar.

Neni 21

Informatat konfidenciale

1. Ndërmarrjet e energjisë që ushtrojnë aktivitete në fushën e energjisë elektrike, energjisë termike apo gazit natyror janë të obliguara të ruajnë informatat konfidenciale gjatë ushtrimit të aktiviteteve dhe kryerjes së detyrave të tyre sipas këtij ligji, përveç nëse me ligje të tjera kërkohet që informatat e tilla të publikohen ose t'i vihen në dispozicion organeve qeveritare sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përcaktimi i informatave konfidenciale bëhet sipas rregullave të nxjerra nga Rregullatori dhe legjislacioni në fuqi.

3. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Rregullatori dhe Ministria, gjatë ushtrimit të autoritetit, funksionit dhe detyrave të tyre, mund t'iu kërkojnë ndërmarrjeve të energjisë edhe informata konfidenciale. Pas pranimit të informatave të tilla nga Rregullatori apo Ministria, nëse konsiderohet se këto informata janë të regjistruara dhe konfidenciale, ato duhet të mbrohen dhe nuk mund të jenë subjekt i ligjeve për qasje në dokumente publike.

KREU VI KONKURRENCA NË AKTIVITETET E ENERGJISË

Neni 22

Ndalimi i kufizimeve mbi konkurrencën

1. Ndërmarrjet e energjisë e kanë të ndaluar të lidhin, marrin pjesë ose të marrin çfarëdo veprimi i cili ka për qëllim avancimin e një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve, një vendim të një asociacioni të ndërmarrjeve dhe praktika të bashkërenduara nëse kjo marrëveshje, vendim apo praktikë ka për qëllim apo efekt parandalimin, kufizimin apo çrregullimin e konkurrencës.

2. Ndalesa e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni zbatohet posaçërisht për marrëveshjet, vendimet ose praktikatat:

2.1. të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë rregullojnë çmimet e shitjes ose blerjes ose kushtet e tjera të tregtimit;

2.2. për kufizimin ose kontrollimin e prodhimit, tregjeve, zhvillimit teknik ose investimeve;

2.3. për ndarjen e tregjeve ose burimeve të furnizimit;

2.4. për zbatimin e kushteve të ndryshme në transaksione ekuivalente me palë të tjera tregtuese, duke i vendosur këto palë në disavantazh konkurrues

2.5. kushtëzimin e përmbylljes së kontratave me pranimin nga palët tjera të obligimeve shtesë të cilat për nga natyra e tyre ose përdorimi komercial nuk kanë lidhje me lëndën e këtyre kontratave;

2.6. të gjitha marrëveshjet dhe vendimet e ndaluara sipas paragrafit 1 të këtij neni do të anulohen automatikisht.

3. Në përputhje me Ligjin për Konkurrencën, dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni mund të shpallen të pazbatueshme për një:

- 3.1. marrëveshje ose kategori të marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve;
- 3.2. vendim ose kategori të vendimeve nga asociacionet e ndërmarrjeve;
- 3.3. praktikë të bashkërenduar ose kategori të praktikave të bashkërenduara, që kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit ose shpërndarjes së mallrave ose në nxitjen e zhvillimit teknik ose ekonomik dhe që njëkohësisht i jep konsumatorëve një pjesë të drejtë të përfitimeve, dhe që:
 - 3.3.1. nuk vendos mbi ndërmarrjet përkatëse kufizime të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave;
 - 3.3.2. nuk u jep këtyre ndërmarrjeve mundësinë e eliminimit të konkurrencës sa i përket një pjese të konsiderueshme të produkteve në fjalë.

Neni 23

Ndalimi i keqpërdorimit të pozitës dominuese

1. Keqpërdorimi i pozitës dominuese nga një ose më shumë ndërmarrje të energjisë është i ndaluar.
2. Keqpërdorimi i pozitës dominuese sipas paragrafit 1 të këtij neni në veçanti përfshin:
 - 2.1. vendosjen e çmimeve të paarsyeshme të shitjes ose blerjes ose kushteve të tjera të tregtimit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë;
 - 2.2. kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik që i dëmton konsumatorët;
 - 2.3. zbatimin e kushteve të ndryshme në transaksione ekuivalente me palë të tjera tregtuese, duke i vendosur këto palë në disavantazh konkurrues;
 - 2.4. kushtëzimin e përmbylljes së kontratave me pranimin nga palët tjera të obligimeve shtesë të cilat për nga natyra e tyre ose përdorimi komercial nuk kanë lidhje me lëndën e këtyre kontratave.

Neni 24

Kompetencat e organeve rregullatore lidhur me çështjet e konkurrencës

1. Rregullatori në kuadër të kompetencave të saj sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, zbaton masa të cilat kanë për qëllim parandalimin e shkeljeve të dispozitave të nenit 22 dhe 23 të këtij ligji.
2. Nëse Rregullatori mbledh dëshmi të arsyeshme mbi një shkelje aktuale ose të dyshuar sipas dispozitave të nenit 22 dhe 23 të këtij ligji nga një ndërmarrje e energjisë, Rregullatori i dorëzon këto dëshmi në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës inicion një hetim të shkeljes së pohuar dhe merrë çfarëdo masa zbatuese të cilat i konsideron të nevojshme dhe të përshtatshme për korrigjimin ose adresimin e shkeljes së pohuar në përputhje me Ligjin për Konkurrencën.

3. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës kryen një hetim, qoftë në bazë të informatave të marra nga Rregullatori ose nga çfarëdo burimi tjetër, përfshirë edhe me veprime të veta, mbi një shkelje të pohuar ose potenciale nga një ndërmarrje e energjisë të Ligjit për Konkurrencën sipas nenit 22 apo 23 të këtij ligji, Rregullatori do të ndihmoj Autoritetin Kosovar të Konkurrencës në kryerjen e këtij hetimi dhe vlerësimin e shkeljes së pohuar.

4. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe Rregullatori nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi i cili përmban dispozita për rregullimin e bashkëpunimit të ndërsjellët për çështjet e përcaktuara në këtë nen.

KAPITULLI VII MASAT E EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN E ENERGISË

Neni 25

E drejta për kufizimin e furnizimit me energji

1. Qeveria, si masë emergjente, mund të vendosë kufizime në furnizimin me energji për konsumatorët, ose të vendosë obligime të veçanta për ndërmarrjet e energjisë në këto raste:

1.1. në gjendje të jashtëzakonshme, në pajtim me përcaktimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

1.2. në situata tjera emergjente, nëse Qeveria ka deklaruar se duhen masa emergjente në sektorin e energjisë;

1.3. çfarëdo aksidenti material në instalimet për prodhimin, transmetimit apo shpërndarjen e energjisë elektrike, termike dhe gazit natyror;

1.4. çfarëdo mungese të papritur ose afatgjate të kapacitetit prodhues energjetik ose kapacitetit të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë;

1.5. çfarëdo aktiviteti terrorist dhe veprimi luftarak.

2. Në rast se Qeveria vendos në bazë të paragrafit 1. të këtij neni, ajo do të miratojë menjëherë një vendim në lidhje me këtë, në të cilin do t'i përshkruajë rrethanat që e justifikojnë vendimin dhe do t'i specifikojnë kufizimet dhe/ose obligimet e ndryshme të cilat imponohen. Qeveria mund ta zbatojë vendimin në fjalë menjëherë dhe do t'ia dërgojë atë Kuvendit brenda tri (3) ditësh kalendarike pas miratimit të tij. Brenda shtatë (7) ditësh kalendarike pas pranimit të Vendimit, Kuvendi do ta miratojë apo do ta refuzojë vendimin në fjalë me shumicë votash të deputetëve të pranishëm në seancë. Nëse Qeveria dështon në parashtrimin e vendimit të vet në Kuvend brenda tri (3) ditësh pas miratimit të tij, apo nëse Kuvendi dështon në miratimin e vendimit në fjalë brenda shtatë (7) ditësh pas pranimit të tij, Vendimi i Qeverisë nuk do të jetë i vlefshëm dhe nuk do të ketë efekt juridik.

3. Vendimi i marrë nga Qeveria sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni dhe i miratuar nga Kuvendi do të jetë i vlefshëm vetëm për atë sa të zgjasin masat emergjente dhe do të ketë kohëzgjatje maksimale prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, përveç nëse i njëjti zgjatet nga Kuvendi. Vendimi mund të zgjatet për periudha të njëpasnjëshme prej tridhjetë (30) ditësh, me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm në seancë, deri në gjithsej njëqindetëdhjetë (180) ditë shtesë. Pas kësaj, kërkohet një vendim i ri i Qeverisë mbi masat e jashtëzakonshme.

4. Kuvendi mund të vendosë kufizime mbi kohëzgjatjen dhe fushëveprimin e vendimit të Qeverisë të miratuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

5. Në rast të rrethanave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Qeveria vendosë zbatimin e masave në vijim në nivel të shtrirjes dhe kohëzgjatjes së nevojshme për të trajtuar efektet negative të rrethanave të tilla:

5.1. të vendosë kufizime mbi aktivitetet komerciale që kanë të bëjnë me burime të caktuara të energjisë;

5.2. të vendosë kushte të veçanta komerciale;

5.3. të kufizojë tregtimin e energjisë ose të vendosë kushte të veçanta për tregtimin e energjisë;

5.4. të detyrojë prodhimin e energjisë që do të ndodhë në objekte të saktësuara të prodhimit; dhe

5.5. të vendosë detyrime për furnizimin me energji për konsumatorë të caktuar, vetëm në pajtim me kriteret e parapërcaktuara dhe objektive të sajura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe të miratuara nga Rregullatori.

6. Ministria shpall të gjitha masat kufizuese përmes mjeteve të informimit publik dhe ia paraqet ato Sekretariatit të Komunitetit për Energji.

7. Ministria me akt nënligjor përcakton rregullat për masat kufizuese të furnizimit me energji në situata emergjente.

8. Ndërmarrjet e energjisë nuk janë të detyruara të paguajnë çfarëdo dëmi të shkaktuar si rezultat i kufizimeve apo ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike, energji termike apo gaz natyror, të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, me përjashtim të atyre rasteve kur Rregullatori ka përcaktuar që emergjenca ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së ndërmarrjes së energjisë apo të ndonjë punëtori të saj. Zyra e Rregullatorit për Energji përcakton procedurat për vlerësimin e neglizhencës së tillë, dëmet e shkaktuara nga ajo, si dhe kompensimin eventual që i duhet paguar konsumatorëve dhe ndërmarrjeve tjera të energjisë. Çfarëdo përcaktimi i tillë nga Rregullatori do t'i nënshtrohet rishikimit gjyqësor në pajtim me Ligjin për Procedurën Administrative.

KAPITULLI VIII

TË DREJTAT PRONËSORE TË NDËRMARRJEVE TË ENERGJISË

Neni 26

Stabilimentet e reja dhe ekzistuese energjetike

Stabilimentet e reja dhe ato ekzistuese për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, termike ose të gazit natyror, do të jenë në pronat mbi të cilat ndërmarrja përkatëse e energjisë i gëzon të drejtat përkatëse të pronësisë, të shfrytëzimit ose të qasjes. Linjat dhe tubacionet për transmetim dhe shpërndarje të energjisë mund të kalojnë përmes,

mbi, në ose nën çdo pronë vetëm nëse ndërmarrja përkatëse e energjisë ka një servitut ose të drejtë të shfrytëzimit të pronës përkatëse, ose servituti apo e drejta e shfrytëzimit i jepet ose i merret nga ndërmarrja përkatëse energjetike në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji.

Neni 27

Prona e cila aktualisht është në shfrytëzim ose posedim të ndërmarrjeve të energjisë

1. Çdo ndërmarrje e energjisë e cila ka në pronësi, shfrytëzim ose ka të drejtën e shfrytëzimit, operon ose ka në posedim stabilimente energjetike të vendosura në një pronë për të cilën ndërmarrja e energjisë nuk ka siguruar ose nuk i është dhënë formalisht një servitut, të drejtën e shfrytëzimit ose të drejtën pronësore dhe këto stabilimente energjetike janë në posedim ose shfrytëzim të ndërmarrjes së energjisë, atëherë kjo ndërmarrje do të ketë të gjitha servitutet, të drejtat e shfrytëzimit dhe të drejtat tjera pronësore në ose ndaj pronës përkatëse. Këto servitute, të drejta të shfrytëzimit ose të drejta pronësore u nënshtrohen kushteve të përcaktuara në këtë nen.

2. Prona në të cilën ndodhen stabilimentet energjetike përveç linjave ose tubave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë do të jepet në shfrytëzim me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vjetëve që fillon nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sipas kësaj të drejte të shfrytëzimit, ndërmarrja përkatëse e energjisë do të ketë të drejtat në vijim:

2.1. të posedojë dhe shfrytëzojë pronën përkatëse për çdo qëllim që nuk është i ndaluar sipas legjislacionit në Kosovë;

2.2. të largojë çdo posedues të jashtëligjshëm nga pronja;

2.3. të kompensohet për dëmet e shkaktuara nga një posedues i paligjshëm në të njëjtën shkallë sikurse pronarët e pronave të paluajshme në pajtim me legjislacionin në fuqi;

2.4. të shesë, të transferojë ose të disponojë lirisht me të drejtën e shfrytëzimit ose cilindo aspekt të saj;

3. Kushtet në vijim aplikohen në raport me të drejtën e shfrytëzimit:

3.1. komunat dhe autoritetet tjera publike mund të mbledhin taksat dhe tarifa nga ndërmarrja e energjisë në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën shkallë sikurse ndërmarrja e energjisë të ishte pronari i pronës;

3.2. ndryshimet fizike në pronën përkatëse, duke përfshirë ndërtimet në atë pronë, nuk ndikojnë në fushëveprimin dhe kushtet e të drejtës së shfrytëzimit;

3.3. e drejta e shfrytëzimit nuk ndikohet nga ndryshimet e të drejtave pronësore mbi pronën përkatëse;

3.4. e drejta e shfrytëzimit mund të shpronësohet vetëm në bazë të kushteve, kërkesave dhe procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kërkesën për pagimin e kompensimit;

3.5. ndërmarrja e energjisë do ta kompensojë në mënyrë të përshtatshme pronarin publik për të drejtën e shfrytëzimit; dhe

3.6. kur është e nevojshme, perimetri i pronës përkatëse do të përcaktohet në përputhje me aktet e aplikueshme nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji.

4. Të gjitha linjat dhe tubat e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë që kalojnë përmes, mbi, në apo nën një pronë konsiderohet se e kanë të drejtën e servitutit të përhershëm mbi pronën e prekur në favor të ndërmarrjes së energjisë duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Servitutet e lartpërmendura u nënshtrohen standardeve dhe kufizimeve të detyrueshme të përcaktuara në aktet nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të këtij ligji.

5. E drejta e shfrytëzimit ose servituti i krijuar me këtë nen përfshin të drejtën e qasjes nga një rrugë ose autostradë publike në pronën përkatëse përmes pronave të tjera nëse kjo qasje kërkohet nga ndërmarrja përkatëse e energjisë për të siguruar funksionimin e rregullt dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve përkatëse energjetike deri në atë shkallë sa kjo të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe ndonjë vendim të aplikueshëm të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

6. Kur një ndërmarrje e energjisë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka një të drejtë të shfrytëzimit në tokën publike e cila është regjistruar në Zyrën Komunale Kadastrale në emrin e saj ose në emër të një Entiteti paraardhës, kjo e drejtë e shfrytëzimit përmes veprimit të këtij ligji i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në dispozitat paraprake të këtij neni.

7. Të drejtat pronësore të krijuara sipas këtij neni si dhe të drejtat pronësore mbi asetet të dhëna gjatë procesit të inkorporimit të një ndërmarrje të energjisë e cila ka qenë e licencuar në vitin 2006 për operimin e sistemit të shpërndarjes ose transmetimit në Kosovë, menjëherë pas kërkesës së ndërmarrjes përkatëse të energjisë do të regjistrohen në emër të saj në Regjistrin përkatës të Drejtave të Pronës së Paluajtshme nga Zyra përkatëse Kadastrale Komunale. Ky regjistrim do të bëhet pavarësisht ekzistimit apo jo të një kontrate për këtë qëllim ndërmjet ndërmarrjes së energjisë dhe pronarit të regjistruar të pronës, nëse ka një pronar të tillë.

8. Gjatë regjistrimit sipas paragrafit 7 të këtij neni, ndërmarrja përkatëse e energjisë duhet të përfshijë në regjistrin e pronave të paluajtshme një njoftim i cili përshkruan të drejtat dhe kufizimet e përcaktuar në paragrafët 9 dhe 10 të këtij neni.

9. Në bazë të kushteve të përcaktuara në paragrafin 10 të këtij neni, çdo person privat i cili konsideron se të drejtat të cilat i janë dhënë një ndërmarrje të energjisë sipas këtij neni i cenojnë të drejtat e tij/saj pronësore në atë mënyrë që mund të konsiderohet si shpronësim për të cilin duhet të paguhet kompensimi sipas Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në çdo kohë brenda tridhjetë e gjashtë (36) muajve nga data e përmbushjes së kushteve të njoftimit për pronën e prekur sipas paragrafit 8 të këtij neni mund të paraqesë kërkesë në gjykatën kompetente të Republikës së Kosovës për pagimin e kompensimit nga Qeveria. Qeveria ka të drejtën e rimbursimit ose zhdëmtimit nga ndërmarrja përkatëse e energjisë për çdo kompensim të cilin gjykata kërkon të paguhet, përveç nëse një kontratë në të cilën Republika e Kosovës është palë shprehimisht përcakton ndryshe. Në rast të vendimit për pagimin e kompensimit, shuma e kompensimit, përcaktohet në përputhje me dispozitat për kompensimin të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe aktet nënligjore të nxjerrura në përputhje me atë ligj.

10. Asnjë kompensim sipas paragrafit 9 të këtij neni nuk do t'i paguhet një personi nëse:

10.1. para datës së dorëzimit të kërkesës për kompensim, të drejtat përkatëse të

regjistruara nga ndërmarrja e energjisë janë paguar ose janë realizuar përmes veprimit të një kontrate ose ligji tjetër (me parashkrim);

10.2. ligji i aplikueshëm në kohën e vendosjes së stabilimenteve në pronën përkatëse nuk ka kërkuar pagimin e kompensimit;

10.3. ligji i aplikueshëm në kohën e vendosjes së stabilimenteve në pronën përkatëse ka lejuar kompensimin, mirëpo pronari ose pronarët e prekur, pa ndonjë arsye bindëse dhe të ligjshme, nuk i kanë ushtruar me kohë të drejtat e tyre ligjore për marrjen e kompensimit brenda afateve të aplikueshme ligjore, afate këto që fillojnë në datën në të cilën stabilimentet së pari janë vendosur në pronën përkatëse; ose

10.4. në kohën e vendosjes së stabilimenteve në pronën përkatëse, prona ka qenë në pronësi shoqërore ose shtetërore.

Neni 28

E drejta e qasjes në pronë

1. Ndërmarrjet e energjisë kanë të drejtë të ndërtojnë stabilimente të reja, apo të zgjerojnë stabilimentet ekzistuese të prodhimit, transmetimit ose shpërndarjes për të cilat nevojitet servituti, të drejtave të shfrytëzimit ose të drejtave të tjera pronësore në tokë publike dhe private, pajisjeve ekzistuese matëse, ose çfarëdo pajisje tjetër, në apo nën tokën publike apo private, me qëllim të furnizimit me energji elektrike, me energji termike dhe gaz natyror sipas dispozitave të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

2. Ndërmarrjet e energjisë në rast të ndërtimit të linjave, stabilimenteve të reja, ose zgjerimin e stabilimenteve ekzistuese të prodhimit, transmetimit ose shpërndarjes, për të cilat nevojitet përvetësimi i servituteve, do ta njoftojë pronarin e tokës private me qëllim të arritjes së marrëveshjes.

3. Ndërmarrja e energjisë duhet ta njoftojë pronarin lidhur me stabilimentin, afatin kohor të nevojshëm për shfrytëzim, ndryshimin e destinimit të tokës, planin e rregullimit pas përfundimit të servitutit dhe vlerën e propozuar të kompensimit sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

4. Në rast se ndërmarrja e energjisë dhe pronari i tokës nuk pajtohen mbi nevojën për krijimin dhe zgjerimin e servituteve në afatin brenda tridhjetë (30) ditësh nga dërgimi i propozimit me shkrim nga ndërmarrja e energjisë, sipas paragrafit 2 të këtij neni, ndërmarrja e energjisë kërkon nga Zyra e Rregullatorit për Energji që ta lëshojë një opinion lidhur me detyrimet e ndërmarrjes së energjisë.

5. Të gjitha servitutet ose të drejtat tjera pronësore të pajtuara në mes të palëve duhet të regjistrohen në Zyrën përkatëse Kadastrale Komunale.

Neni 29

Inspektimet mirëmbajtja dhe matja

1. Personat fizikë dhe juridik do të lejojnë zyrtarët që ushtrorjnë inspekte në përputhshmëri me këtë ligj, të mund të hyjnë dhe të kalojnë në pronën e çfarëdo individi për ushtrimin e aktiviteteve të tyre në lidhje me inspektimin dhe mirëmbajtjen e stabilimenteve energjetike, instalimeve apo sistemeve.

2. Personat fizikë dhe juridik do t'iu lejojnë përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve të energjisë qasje në pronën e tyre në të cilën gjenden stabilimentet, aparaturat, rrjetet, ose sistemet energjetike në të cilat qasja e tillë është e nevojshme, me qëllim të mirëmbajtjes apo kontrollimit të tyre, prerjes së pemëve ose vegjetacionit tjetër që mund të pengoj veprimin e stabilimenteve, aparaturës, rrjeteve ose sistemit.

3. Personat fizikë dhe juridikë duhet t'iu lejojnë qasje përfaqësuesve të autorizuar të ndërmarrjeve të energjisë, për inspektimin e pajisjeve për matje që gjenden në pronën e tyre, në të cilën qasja e tillë është e nevojshme, dhe nuk mund të ndalojnë përfaqësuesit e ndërmarrjeve të energjisë të bëjnë shkyçjen e pajisjeve për matje ose aparatrave të tjera në lidhje me sistemin e energjisë.

Neni 30

Kompensimi i dëmeve

1. Ndërmarrjet për energji i kompensojnë pronarët ose shfrytëzuesit e pronës për çfarëdo dëmi që mund të shkaktohet gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre që mund të rezultojë në kufizimin e shfrytëzimit të pronës ose zvogëlimin të vlerës së saj.

2. Kriteret dhe kushtet e kompensimit rregullohen sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 31

Zonat e sigurisë

1. Zonat e sigurisë duhet të vendosen përreth zonave energjetike.

2. Brenda çfarëdo zone të sigurisë është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi ose ngritja e çfarëdo ndërtese apo godine, prerja e bimëve ose pemëve, ose ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, jetës dhe pronës.

3. Ministria me akt nënligjor i përcakton kushtet dhe mënyrat e përcaktimit të lokacionit, madhësinë, kufijtë e zonave të sigurisë, rregullimin e tyre si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve.

Neni 32

Cenimi i Zonave të Sigurisë

1. Kur pronarët ose shfrytëzuesit e pronës bëjnë ndërtime të palejuara, rrethime, prerje ose aktivitete të tjera që janë në kundërshtim me rregullat për zonat e sigurisë, dhe kur dështojnë përpjekjet për ndalimin e ndërtimeve ose aktiviteteve të tilla ilegale të paautorizuara brenda afateve kohore të vendosura nga ndërmarrjet e energjisë. Ndërmarrja e energjisë është e autorizuar që të kërkojë nga komuna ndalimin dhe heqjen e ndërtimeve ilegale ose ndalimin e aktiviteteve, me shpenzime të pronarit ose shfrytëzuesit.

2. Komuna që pranon kërkesë të tillë nga ndërmarrja e energjisë, brenda shtatë (7) ditësh i kryen veprimet e rrënimit të ndërtimit joligjor apo e ndalon aktivitetin joligjor.

KAPITULLI IX MBIKËQYRJA

Neni 33

Mbikëqyrja dhe inspektimi

1. Mbikëqyrja administrative e zbatimit të ligjeve të energjisë si dhe akteve nënligjore kryhet nga Ministria.

2. Inspektimet e duhura për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji kryhen nga Inspektorati i Energjisë, që vepron në kuadër të Ministrisë. Inspektorati i Energjisë, nëse konsideron se është e nevojshme, kryen inspektime të stabilimenteve energjetike dhe përgatit raporte mbi inspektimin.

3. Nëse Rregullatori e konsideron të nevojshme, ai mund t'i kërkojë Inspektoratit të Energjisë që të kryejë pa pagesë inspektime të objekteve të energjisë dhe t'ia dorëzojë Rregullatorit raportin me shkrim mbi inspektimin.

4. Të gjithë personat fizikë ose juridik që posedojnë ose operojnë stabilimente, pajisje, objekte, sisteme ose instalime energjetike, për të cilat sipas këtij ligji parashihet inspektimi, obligohen të informojnë menjëherë inspektoratin e energjisë mbi çfarëdo dëmi ose gabimi që mund të shfaqet si pasojë e ndërprerjes së furnizimit të energjisë, ose nëse ekziston rreziku për jetën, shëndetin e njerëzve, trafikut, objekteve fqinje apo mjedisit rrethues.

5. Gjatë inspektimit i cili do të kryhet sipas kushteve të këtij ligji, Inspektorati i Energjisë ka të drejtë në qasje në pajisjet dhe stabilimentet për qëllimet e përcaktuara në nënparagrafët 5.1 deri 5.5 të këtij neni. Të gjitha ndërmarrjet energjetike apo personat tjerë fizikë apo juridik sigurojnë qasje të tillë nëse një gjë e tillë kërkohet nga përfaqësuesi i autorizuar i Inspektoratit të Energjisë, të cilët:

5.1. inspektojnë pajisjet, materialet si dhe dokumentacionet teknike të tjera në përputhshmëri me qëllimin e inspektimit ose mbikëqyrjes;

5.2. marrin mostra apo kërkojnë sigurimin e provave apo mostrave të nevojshme;

5.3. inspektojnë dokumentet apo të dhëna tjera nga ndërmarrjet energjetike apo organizata profesionale ose ekspertë individual;

5.4. shqyrtojnë shërbimet energjetike në përgjegjësinë e tyre; dhe

5.5. kryejnë inspektime të gjendjes teknike dhe sigurisë së pajisjeve energjetike në bazë të rregullt ose kurdo që kërkohet.

6. Nëse inspektorët e Inspektoratit gjatë inspektimit të tyre mbikëqyrës vërejnë se një ndërmarrje energjetike apo një konsumator i energjisë nuk i kryen operacionet në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera përkatëse, krahas autorizimeve të përgjithshme me akte të përgjithshme, Inspektorati i energjisë ka autoritet të nxjerrë vendime me shkrim si në vijim:

6.1. të udhëzojë eliminimin e mangësive të konfirmuara brenda një periudhe të caktuar kohore;

6.2. të ndaloj ndërtimin e objekteve të prodhimit, nëse nuk janë siguruar të gjitha lejet e nevojshme për ndërtim;

6.3. të udhëzojë pezullimin e ndërtimit apo shfrytëzimin e mëtutjeshëm të objektit energjetik; apo

6.4. të udhëzojë ndërprerjen e furnizimit të energjisë apo shfrytëzimit të energjisë nëse pajisjet apo objekti nuk është duke prodhuar apo nëse objektet nuk ndërtohen, shfrytëzohen apo mirëmbahen në pajtim me kërkesat teknike të kodeve, rregullave apo akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe nëse ka rrezik të drejtpërdrejtë ndaj objektit energjetik dhe sigurisë së ndërtesës, shëndetit, jetës, sigurisë së qarkullimit dhe sigurisë së ndërtesave fqinje.

7. Nëse, si rrjedhojë e inspektimit, Inspektorati i Energjisë beson se një ndërmarrje e energjisë apo një tjetër person fizik apo juridik vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, Ligjit për Energjinë Elektrike, Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Ligjit për Energjinë Termike, Ligjit për Gazin Natyror apo akteve tjera nënligjore që burojnë nga këto ligje, Inspektorati i Energjisë mund të ndërmarrë këto veprime:

7.1. të nxjerrë njoftim me shkrim që përmban udhëzime të detyrueshme për korrigjimin e shkeljeve brenda një afati të caktuar;

7.2. t'i propozojë Rregullatorit që të pezullojë, ndryshojë ose tërheqë licencën përkatëse;

7.3. t'i propozojë Rregullatorit të vendosë gjoha administrative dhe dënime sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë;

7.4. ta dërgojë çështjen para autoriteteve kompetente gjyqësore për të ndërmarrë masa të mëtutjeshme që nuk janë nën mandatin e Inspektoratit; apo

7.5. ta informojë publikun mbi çfarëdo veprimtarie ilegale.

8. Aktivitetet e inspektimit të kryera nga Inspektorati i Energjisë nuk parandalojnë apo kufizojnë inspektimet në të gjitha premiset nga autoritetet tjera, kompetencat e të cilave përcaktohen me ligje tjera, veçanërisht përkitazi me inspektimet në lidhje me pajtueshmërinë e ligjeve dhe standardeve mbi mbrojtjen mjedisore dhe shëndetin publik.

Neni 34

Ruajtja e informatave

1. Inspektorët e Inspektoratit të Energjisë duhet të mbajnë konfidenciale çfarëdo informate zyrtare ose komerciale që ata e hasin gjatë ushtrimit ose në lidhje me inspektimet e tyre.

2. Inspektorët e Inspektoratit të Energjisë ushtrojnë aktivitetet e tyre vetëm ose në rast të nevojës, së bashku me organe të specializuara të kontrollit sipas legjislacionit në fuqi.

KAPITULLI X DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 35 Dispozitat kalimtare

1. Nëntë (9) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji të gjitha aktet, vendimet, rregullat dhe dokumentet tjera të miratuara apo të shpallura sipas Ligjit Nr. 03/L-184 për Energjinë duhet të harmonizohen me këtë ligj.

2. Me qëllim të zbatimit të këtij ligji, Ministria nxjerr akte nënligjore të përcaktuara me këtë ligj, brenda nëntë (9) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 36 Dispozita shfuqizuese

1. Ky ligj shfuqizon:

- 1.1. Ligjin Nr. 03/L-184 për Energjinë;
- 1.2. Udhëzimin Administrativ Nr.07/2011 mbi rregullat për balancat e energjisë;
- 1.3. Udhëzimin Administrativ nr. 2005/6 mbi rregullat për masat kufizuese të furnizimit me energji;
- 1.4. Udhëzimin Administrativ nr. 2005/7 mbi rregullat për zonat e sigurisë;
- 1.5. Udhëzimin Administrativ Nr. 2005/2 mbi përcaktimin e rregullave për të drejtën e ndërtimit apo të zgjerimit të stabilimenteve ekzistuese energjetike për bartjen dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, ngrohjes, apo gazit natyror në tokën joprivatë;
- 1.6. Udhëzim Administrativ nr. 2005/3 mbi rregullat për të drejtën e kalimit dhe të qasjes në tokën private: kriteret dhe kushtet për kompensim;
- 1.7. Udhëzimin Administrativ nr.2005/1 mbi Inspektoratin e Energjisë.

Neni 37 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L-081
16 qershor 2016**

Shpallur me dekretin Nr. DL-025-2016, datë 01.07.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.

